



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr: 224

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË AUTORITETI TË MEDIAS AUDIOVIZIVE TË
PASQYRIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË
PËR PERIUDHËN 26.3.2021 – 3.4.2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”

V Ë R E J:

Baza ligjore: nenet 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr.2, datë 30.01.2021 i Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”.

Neni 85, paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor përcakton se radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së), menjëherë në dispozicion të saj.

Neni 8 i vendimit nr. 2, datë 30.01.2021, i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive” parashikon se OSHMA-t vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo ditë pasardhëse monitoruese”.



Referuar vendimit nr.51, datw 6.4.2021 tw AMA-s, konstatohet si vijon:

Depozitimi i regjistrimeve në AMA

1. Subjektet audiovizivë të cilët nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021 janë si më poshtë:

- TV Skampa
- TV Adria Net
- TV Channel 1
- TV Kopliku
- TV Antena Nord
- TV Klaudiana
- TV Channel 7
- TV Jug
- TV Gold
- TV Glob
- TV Puka
- TV 4
- TV Mati

AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje mase administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor

2. Subjektet audiovizivë të cilët kanë depozituar regjistrime **jo** për të gjitha ditët e kësaj periudhe janë:

- TV Bulqiza
- TV Alpo
- TV Rozafa
- TV RE.AL
- TV Apollon
- TV Berati
- TV Sot 7
- TV Star Plus
- TV Best Channel
- TV 6+1
- One TV Vlora



- TV Saranda
- TV Lobi
- TV Kukësi
- Zjarr TV

AMA i propozon KQZ-së t’u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve, për respektimin e plotë të këtij detyrimi.

3. Neni 81 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20% të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive private.

Referuar të dhënave të tabelës nr.1, për edicionet e lajmeve, AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-t e mëposhtme të bëjnë kompensimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim:

Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD	PDIU
1	RTSH 1	35 min	-	34 min	40 min	40 min
2	RTSH 2	5 min	-	4 min	7 min	7 min
3	TV Klan	57 min	-	61 min	73 min	73 min
4	TV Top Channel	7 min	-	20 min	20 min	20 min
5	TV Vizion Plus	33 min	-	39 min	44 min	47 min
6	RTSH 24	22 min	-	20 min	23 min	23 min
7	Klan Plus	26 min	-	17 min	25 min	25 min
8	Klan News	128 min	-	75 min	105 min	105 min
9	Top News	35 min	-	41 min	48 min	48 min
10	Kanal 7	15 min	-	14 min	19 min	19 min
11	News 24	20 min	-	28 min	59 min	57 min
12	ABC News	-	4 min	18 min	25 min	25 min
13	RTV Ora	17 min	-	12 min	22 min	23 min
14	Report TV	98 min	-	59 min	75 min	80 min
15	TV Scan	9 min	-	49 min	49 min	49 min



16	TV Ora News	22 min	-	9 min	24 min	26 min
17	TV Shijak	-	38 min	-	85 min	85 min
18	EuroNews Balkans	-	5 min	25 min	49 min	49 min
19	Fax News	25 min	-	14 min	29 min	36 min
20	Syri TV	-	25 min	43 min	73 min	73 min
21	TV Apollon	21 min	-	174 min	174 min	174 min
22	TV Alpo	35 min	-	-	35 min	35 min
23	A2 CNN	18 min	-	19 min	45 min	47 min
24	TV Bulqiza	-	16 min	19 min	29 min	34 min
25	TV Berati	11 min	-	18 min	18 min	18 min
26	RE.AL	-	13 min	50 min	36 min	50 min
27	MCN TV	24 min	-	26 min	24 min	26 min
28	TV Rozafa	28 min	-	29 min	65 min	65 min
29	TV Skampa	9 min	-	49 min	49 min	49 min
30	Zjarr TV	-	10 min	-	55 min	55 min
31	Adria Net	-	-	17 min	17 min	17 min

Referuar nenit 81 në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend.. Komisioneri analizon vendimarrjen e tij për kompensimin e minutazhit si vijon:

Neni 65 pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Në kuptim të kësaj dispozite, PDIU garon në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 si pjesë e koalicionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe të drejta dhe detyrimet që ligji ia njeh partisë parlamentare PDIU përmbushen nga koalicioni. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërcituar Komisioneri vendos që të përjashtojë PDIU nga përfitimi i kompensimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim.

4. AMA ka identifikuar dhe ka raportuar në informacionet ditore për KQZ se subjekti TV Bulqiza ka përfshirë në përmbajtjet e saj audiovizive dhe transmetimin e edicioneve informative të një OSHMA-je tjetër.(datat 28, 29, 31 mars 1, 2, 3 prill 2021)

AMA i propozon KQZ-së që ti drejtohet OSHMA-së për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër.

5. Transmetimi i reklamave politike

Në zbatim në nenit 84 , paragrafi 4 dhe 5 i Kodit Zgjedhor , OSHMA-të të cilat nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor në lidhje me oraret e transmetimit të reklamave politike për periudhën 26.03.2021-03.04.2021:

- TV Klan (data 26 mars 2021)
- TV Vizion Plus (data 29 mars 2021)
- Klan News (data 27, 30,31 mars 2021, 2 prill 2021)
- ABC News (data 26 mars 2021)
- RTV Ora (data 26 mars 2021)
- Syri TV (data 27,28 mars 2021)
- A2 CNN (data 31 mars 2021)
- TV Shijak (data 26,27,28,29,30,31 mars1,2 dhe 3 prill 2021)
- TV Apollon (data 28,29,30,31 mars1,2 dhe 3 prill 2021)
- RE.AL (data 26,27,28,29,30,31 mars1 , 2 prill 2021)

AMA i propozon KQZ-së ti kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.

6. AMA ka konstatuar raste të transmetimit të reklamës politike brenda edicionit të lajmeve nga OSHMA-të

- Klan News
- Alpo
- RE.AL

(të raportuara nga AMA në KQZ në datat 31 mars 1, 2 dhe 3 prill 2021)

AMA i propozon KQZ-së ti kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve (të cilat nuk mund të sponsorizohen)

7. Subjekti audioviziv RE.AL ka tejkaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues, pasi ka transmetuar 283.6 minuta reklamë politike për partinë Bindja

Demokratike. Sipas pikës 9 të nenit 84 të KZ, koha e transmetimit të reklamave për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore.

AMA i propozon KQZ-së ti kërkojë subjektit të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për këtë subjekt zgjedhor.

8. Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë_

Sa i takon vlerësimit gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën elektorale, përveç operatorëve RTSH1, Shijak TV, Apollon, Rozafa, MCN dhe Adria Net, të cilët kanë pasur përfaqësim të balancuar, pjesa tjetër ka disbalancë për këtë tregues.

OSHMA-të kombëtare dhe lokale/rajonale që mbulojnë më shumë se 48% të popullsisë rezultojnë se nuk kanë respektuar raportin e përfaqësimit gjinor në pasqyrimin e fushatës zgjedhore.

AMA i propozon KQZ-së ti tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të jenë më të ndjeshëm dhe të vëmendshëm në respektimin e këtij kriteri.

9. Publikimi i sondazheve zgjedhore Nisur nga monitorimi i respektimit të kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor (publikimi i sondazheve zgjedhore) nuk është identifikuar ndonjë rast ku janë shkelur kërkesat e Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T’u tërheqë vëmendjen, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të depozituar pranë AMA-s regjistrime për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021, në zbatim të pikës 6, të nenit 85, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 8, të vendimit nr.2, datë 30.1.2021, të Komisionit Rregullator, “Për Metodologjinë e Monitorimit të Medias Audio dhe Audiovizive”, nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-të) si më poshtë vijon:



- TV Skampa
- TV Adria Net
- TV Channel 1
- TV Kopliku
- TV Antena Nord
- TV Klaudiana
- TV Channel 7
- TV Jug
- TV Gold
- TV Glob
- TV Puka
- TV 4
- TV Mati
- TV Bulqiza
- TV Alpo
- TV Rozafa
- TV RE.AL
- TV Apollon
- TV Berati
- TV Sot 7
- TV Star Plus
- TV Best Channel
- TV 6+1
- One TV Vlora
- TV Saranda
- TV Lobi
- TV Kukësi
- Zjarr TV

2. Të bëjnë kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim, në zbatim të nenit 81, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, OSHMA-të e mëposhtme:



Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD
1	RTSH 1	35 min	-	34 min	40 min
2	RTSH 2	5 min	-	4 min	7 min
3	TV Klan	57 min	-	61 min	73 min
4	TV Top Channel	7 min	-	20 min	20 min
5	TV Vizion Plus	33 min	-	39 min	44 min
6	RTSH 24	22 min	-	20 min	23 min
7	Klan Plus	26 min	-	17 min	25 min
8	Klan News	128 min	-	75 min	105 min
9	Top News	35 min	-	41 min	48 min
10	Kanal 7	15 min	-	14 min	19 min
11	News 24	20 min	-	28 min	59 min
12	ABC News	-	4 min	18 min	25 min
13	RTV Ora	17 min	-	12 min	22 min
14	Report TV	98 min	-	59 min	75 min
15	TV Scan	9 min	-	49 min	49 min
16	TV Ora News	22 min	-	9 min	24 min
17	TV Shijak	-	38 min	-	85 min
18	EuroNews Balkans	-	5 min	25 min	49 min
19	Fax News	25 min	-	14 min	29 min
20	Syri TV	-	25 min	43 min	73 min
21	TV Apollon	21 min	-	174 min	174 min
22	TV Alpo	35 min	-	-	35 min
23	A2 CNN	18 min	-	19 min	45 min
24	TV Bulqiza	-	16 min	19 min	29 min
25	TV Berati	11 min	-	18 min	18 min
26	RE.AL	-	13 min	50 min	36 min
27	MCN TV	24 min	-	26 min	24 min
28	TV Rozafa	28 min	-	29 min	65 min
29	TV Skampa	9 min	-	49 min	49 min
30	Zjarr TV	-	10 min	-	55 min
31	Adria Net	-	-	17 min	17 min

3. Ndërprejten e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, në zbatim të nenit 84, pikat 4 e 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për OSHMA-të si më poshtë vijon:

- TV Klan
- TV Vizion Plus
- Klan News
- ABC News
- RTV Ora
- Syri TV
- A2 CNN
- TV Shijak
- TV Apollon
- RE.AL

4. Të ndërpritet menjëherë transmetimi i reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve, në zbatim të pikës 1, të nenit 84, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar për OSHMA-të si më poshtë vijon:

- Klan News
- Alpo
- RE.AL

5. Subjekti televiziv RE.AL në zbatim të pikës 9, të nenit 84, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për subjektin zgjedhor Partia Bindje Demokratike.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

